

Kryeministrit iu çorr maska përfundimisht

[Gazeta Shqiptare, 5.4.2006]

Para pak ditësh, në shkrimin “Kryeministri do t’i godasë të pabindurit”, botuar në “Gazeta Shqiptare, 31.3.2006”, patëm parashikuar se kryeministri do te godiste deputetët e komisionit të ekonomisë. Parashikimi ynë u vërtetua: Dje, deputeti Ngjela, u shkarkua nga çdo funksion. Nuk e sollën në vete kryeministrin, as paralajmërimet dhe as qëndrimi i kthjelltë i deputetit: Ai, i tërbuar theu çdo normë demokratike.

Falë shkathtësisë së një grupi gazetarësh shakaxhinjë, ata të “Fiks fare”, shqiptarët më së fundi kanë rastin të shohin fytyrën e vërtetë të kryeministrit, të shohin se sa “demokrat”, se sa i “ndryshuar” është ai. Me qëndrimin që nuk i takon as edhe një monarku të mesjetës, ai urdhëroi shkarkimin e një deputeti nga te gjitha funksionet. E si mund të urdhërojë një kryeministër, deputetët: ku është pavarësia e tre pushteteve?

Ne i kemi jetuar këto sjellje të z. Berisha në vitin 1997, dhe kemi paralajmëruar se kush është ai, por jemi interpretuar se kemi “mëllefe”. E vërteta është e vështirë të besohet.

“Por zoti vonon, por nuk harron”. Ja që tashmë shqiptarët kanë në dorë një inçizim autentik të dialogut historik dhe histerik, Berisha-Ngjela, i cili vërteton katërcipërisht se kush është në fakt, “kryeministri i ndryshuar”. Tani nuk ka mundësi më të thuhet se “ia kanë shpifur”, sepse Ai, në tërbimin e tij diktatorial, nuk u ndalua, por i çoi deri në fund kërcënimet që dëgjuam të inçizuara, dhe makina e tij policore, PD-ja aktuale, u vu në lëvizje, veptoi, para se ta dinte se ishte “regjistruar”.

Por ky veprim automatik i PD-së aktuale, është dhe më e rënda: nuk vonoi as disa orë, dhe nga selia e PD-së, u përhap lajmi zyrtarisht: Spartak Ngjela shkarkohet nga ky e ai funksion. E ky është mjerimi më i madh: si janë kthyer të gjithë kokat e PD-së në butona të komandueshëm nga një njeri: nga kryeministri? Si nuk pritën së paku formalisht të mbledhin forumet, t’u japin rendin e ditës, t’u japin kohën e nevojshme të mendojnë njerëzit që janë pjestarë në këto forume, dhe pastaj të marrin këto vendime. Këto janë normat më elementare të procedurave demokratike, të të gjithë partive që nuk janë naziste ose komuniste.

Besojmë se edhe partitë popullore evropiane, edhe perëndimi më gjërë, do te jenë më të kujdesshëm tani e mbrapa, me këta njerëz që po i pranojnë, mbase nën moton “buono per l’Albania” (“ku të gjeshë më të mirë për Shqipërinë”). Nuk ka pasur kurrë sukses përdorimi i një të keqeje për të shpërlarë një të keqe tjetër. Këtë ata duhet ta dinë mirë. Nuk ka dhënë sukses përkrahja e diktatorëve, edhe kur ka qenë nevoja te mposhtesh komunizmi, në vitet 50-70, e jo tashti. Nuk duhej të vareshin shpresa tek një njeri i rrezikshëm, si kryeministri ynë aktual, për t’i lënë ati të zgjidhë “shpejt” probleme shqiptare, qofshin edhe shumë të rrezikshme për perëndimin, si trafiqet nga Shqipëria, apo kanalet e Bin Ladenit shqiptare etj. E themi këtë, sepse ne shqiptarët jemi të uritur për miqësinë me perëndimin, dhe paralizohemi, na bëhet lavazh truri, kur shohim se e përkrah perëndimi një njeri, sado i diskredituar të ketë qenë tek ne: ne, edhe për respekt të perëndimit, shkuam dhe ricikluam atë njeri, gjë që shumë popuj të tjerë, nuk do ta bënin. Nejse, fajin kryesor e kemi vetë, ne shqiptarët.

Kjo që ngjau, nuk ka të bëjë vetëm me PD-në, nuk është një çështje e brendëshme vetëm e saj, por është e gjithë Shqipërisë: është paralajmërim i gjëmës që i kërcënohet vendit, nga Diktatori i Madh.

Bashkim Kopliku

Durrës, më 4.4.2006